

## Vendim nr. 104 datë 20.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 4 (N) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** NIKOLL KOLTHI përfaqësuar nga avokatët Erjon Gjoni dhe Shaqir Hasanaj, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1800, datë 07.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 28, 29 e 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 03, datë 07.01.2015, ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit Nikoll Kolthi (*kërkuesi*) për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e mbetur në tentativë dhe “Prodhimi dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79/dh-22, 278/2 e 55 të Kodit Penal (*KP*), duke e dënuar me 20 vjet burgim. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 314, datë 29.07.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Vendimi ka marrë formë të prerë dhe ndaj tij nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesë me objekt rishikimin e vendimit penal të formës së prerë.

2. Në procesin e rishikimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 31, datë 05.02.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke arsyetuar se pasi ka marrë në analizë të gjitha faktet vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi, me objekt rishikimin e vendimit penal, nuk është e bazuar në ligj dhe në prova, e për rrjedhojë nuk duhet të pranohet. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 160, datë 04.06.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me arsyetimin se ai është marrë në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, si dhe në provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pretendimet e kërkuesit nuk qëndrojnë në themel, pasi nuk vërtetohet ekzistenca e rrethanave të përcaktuara në nenin 450, pika 1, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Kundër këtij vendimi, në datën 17.07.2018, kërkuesi ka ushtruar rekurs.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1800, datë 07.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të *KPP*-së.

5. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në datën 27.03.2024, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë*, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është marrë në

kundërshtim me nenin 383 të KPP-së, nuk është bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe është arsyetuar bazuar në përmbajtjen e një vendimi tjetër, pasi në pikën 14 të faqes 8 të vendimit të Gjykatës së Lartë ky kolegji ka përmendur Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, ndërkohë që rekursi i kërkuesit është ushtruar kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër. Po kështu, duke vendosur mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë një zgjidhje përfundimtare dhe të arsyetuar çështjes objekt shqyrtimi.

6.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, aq më tepër kur në rastin konkret rekursi ushtrohej kundër një vendimi rishikimi. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata e Lartë ka cenuar edhe *parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*. Për shkak të pozicionit të saj si gjykatë ligji, ajo duhet të shqyrtonte pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në seancë gjyqësore dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to. Vendimet gjyqësore që kanë deklaruar fajësinë e kërkuesit janë bazuar vetëm në deklaratimet e shtetasve A.P. dhe E. P., deklarime të cilat nuk i janë nënshtruar debatit real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, pasi ata nuk janë pyetur si dëshmitarë në gjykim, në kundërshtim me nenin 390, pika 1, të KPP-së.

## II

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me procesin e rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se vlerësimi i respektimit të standardeve kushtetuese gjatë këtij procesi i nënshtrohet juridiksionit kushtetues (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 61, datë 27.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në këtë situatë Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për sa i përket procesit gjyqësor të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi ky proces është përmbyllur përmes vendimit nr. 00-2023-1800, datë 07.11.2023 të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 05.03.2024 dhe pas plotësimit të tij është regjistruar në Gjykatë në datën 27.03.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Në drejtim të legjitimitit *ratione materia*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

13. Nisur nga thelbi i pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Kolegji çmon që pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të analizohet në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë.

*B Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë*

14. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me nenin 383 të KPP-së, nuk është bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe është arsyetuar bazuar në përmbajtjen e një vendimi tjetër, pasi në pikën 14 të faqes 8 të vendimit të Gjykatës së Lartë, ky kolegji ka përmendur Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, ndërkohë që rekursi i kërkuesit është ushtruar kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër. Po kështu, duke vendosur mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë një zgjidhje përfundimtare dhe të arsyetuar çështjes objekt shqyrtimi.

15. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ndërkohë, neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

16. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e Kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket aksesit, po sipas Gjykatës, ky standard nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 6, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Duke iu kthyer rastit objekt shqyrtimi, referuar akteve shkresore të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të kërkesës, Kolegji vëren se ai ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, përmes të cilit është dënuar me 20 vjet burgim. Gjykatat e faktit kanë vendosur rrëzimin e kërkesës së tij si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke çmuar se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 450 të KPP-së, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së, qëndrim i cili, në thelb, është mbështetur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që edhe pse ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi shkaqet e parashtruara në të nuk u referoheshin shkaqeve të parashikuara në nenin 432 i KPP-së, ka vlerësuar edhe vendimmarrjen e tyre. Në këtë kuptim, Kolegji Penal ka arsyetuar se gjykatat e faktit kanë analizuar dhe shqyrtuar provat në zbatim të ligjit procedural penal dhe si rrjedhojë e kësaj analize kanë arritur në përfundimin se kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor është e papranueshme. Po kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vënë në dukje se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve në lidhje me sa është parashtruar në ankim (*shih paragrafët 5, 7 e 14 të vendimit nr. 00-2023-1800, datë 07.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

18. Duke mbështetur qasjen e gjykatave të faktit, Kolegji Penal ka çmuar se nuk gjen shkaqe për pranimin e kërkesës së kërkuesit, pasi pretendimet që ka ngritur në rekurs janë pretendime, të cilat janë trajtuar nga gjykatat e faktit në drejtim të kërkimit të ekzistencës së provave të reja, të tilla që e bëjnë të rishikueshëm vendimin e dënimit. Sipas tij, ndryshimi i mëvonshëm i deklarimeve të dëshmitarëve nuk mund të shërbejë si element i domosdoshëm për rishikimin e vendimit. Po sipas Kolegji Penal, vetëm në rastet kur dëshmitari është dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë për dëshmi të rreme dhe kur dëshmia e tij është e vetmja që mund të adresojë fajësinë e autorit, atëherë ajo mund të shërbejë për të kërkuar rishikimin e vendimit gjyqësor. Por edhe në raste të tilla duhet kryer një analizë e detajuar në raport me provat e tjera që ka marrë në shqyrtim gjykata në kohën e deklarimit fajtor të kërkuesit. Vetëm në këtë rast mund të shërbejë si një motiv i vlefshëm dëshmia e një shtetasi rreth ngjarjes. Po kështu, ky kolegji ka vënë në dukje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 12, 13 e 14 të vendimit nr. 00-2023-1800, datë 07.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

19. Në këndvështrim të sa më lart, në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, Kolegji çmon se arsyetimi i Gjykatës së Lartë në lidhje me përfundimin e arritur për kërkimin e kërkuesit nuk rezulton të jetë kontradiktor ose i paqartë në përmbajtje. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloj vendimesh, duke respektuar në këtë mënyrë standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Po

kështu, gabimi në referim në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Lartë, ku përmendet Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, kur në fakt bëhet fjalë për Gjykatën e Apelit Shkodër, nuk e cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Po në këtë drejtim, Kolegji konstaton, gjithashtu, se Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuarit në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë, dhe vetëm pse është disponuar me mospranim rekursi, kjo nuk do të thotë se është cenuar ky standard.

20. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë janë haptazi të pabazuara.

21. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.